# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-455555**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘Krizë’ në Izrael, vendi përballet me mungesë trupash dhe pajisjesh ushtarake |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/krize-ne-izrael-vendi-perballet-me-mungese-trupash-dhe-pajisjesh-ushtarake-i586914` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:45:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 16:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f219dbc17324469f0a35c8fd71c92598cbd1b46bfadd72448d9e53e403f94d57` |
| TEKSTI | `fd94dc7c37c5f313a824b1a4b96181ba140d17aec9394ea6fc9311c4de095f2c` |
| PAMJA | `8e86a699933f47e095483decd69effcf8b87e8f268d76d2e35c8ac3f55d5316e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `22edf5b65520e316f1f6ac8a70b51e5144cd660ac81fb51219f3cc5bfd6bb3d0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/22edf5b65520e316f1f6ac8a70b51e5144cd660ac81fb51219f3cc5bfd6bb3d0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# ‘Krizë’ në Izrael, vendi përballet me mungesë trupash dhe pajisjesh ushtarake


TemA

18 Shtator 2026, 18:00Bota TEMA




Ushtria izraelite po përballet me mungesë të konsiderueshme të personelit dhe pajisjeve ushtarake, pas gati tre vitesh operacionesh dhe konfliktesh në disa fronte.

Sipas gazetës izraelite Maariv, situata e krijuar ka bërë që ushtria të shqyrtojë masa për kufizimin ose shtyrjen e largimit të ushtarëve nga shërbimi.

Gazeta raporton se mungesa e personelit po ushtron presion të madh mbi ushtrinë, ndërsa njëkohësisht vazhdojnë procedurat për përgjegjësinë e oficerëve lidhur me ngjarjet e tetorit 2023.

Maariv përmendi edhe shkarkimin e një nënkoloneli që kishte shërbyer si oficer i inteligjencës në Divizionin e Gazës, duke e lidhur vendimin me përgjegjësinë e tij komanduese.

Probleme të rëndësishme janë raportuar edhe në lidhje me pajisjet ushtarake. Sipas Maariv, ushtria nuk disponon numër të mjaftueshëm tankesh dhe transportuesish të blinduar, ndërsa qindra mjete janë dëmtuar gjatë operacioneve ushtarake të viteve të fundit.

Në të njëjtën kohë, Channel 12 raportoi se ushtria izraelite nuk arriti të realizojë një blerje të planifikuar prej 12 helikopterësh sulmues Apache të prodhuar nga Boeing, për shkak të kufizimeve në buxhetin e prokurimeve ushtarake.

Sipas këtij raportimi, ushtria ka paralajmëruar gjithashtu se, nëse nuk sigurohen fonde shtesë, mund të ngadalësohen ose të ndalen proceset për riparimin dhe rikthimin në shërbim të tankeve dhe automjeteve të blinduara të dëmtuara. Në rrezik mund të jenë edhe disa linja të prodhimit të municioneve.

Këto zhvillime vijnë në një periudhë kur Izraeli ka zhvilluar operacione ushtarake në disa zona të rajonit, përfshirë Gazën, Libanin, Iranin, Bregun Perëndimor dhe Sirinë.

Sipas raportimeve të mediave izraelite, presioni mbi buxhetin dhe personelin e ushtrisë është rritur ndjeshëm gjatë kësaj periudhe.

Megjithatë, të dhënat mbi kapacitetet reale ushtarake, humbjet dhe gjendjen e pajisjeve mbeten pjesërisht të kufizuara për shkak të kufizimeve mbi publikimin e informacionit ushtarak.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Kriza energjetike, Macron thërret G7: Diskutohet çlirimi i rezervave strategjike

16:40 Bota

I dërguari amerikan: SHBA-ja po "shkon në drejtimin e duhur" me Bjellorusin

14:30 Bota / 1 koment

[Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik]

14:10 Bota



[Fico: Nuk dua që Sllovakia të përfshihet në luftë për shkak të Nenit 5 të NATO-s]

13:40 Bota / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.